EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8423
E martë, 3 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Në Mirditë, Çmimi për Veprën Jetësore "Teuta" i akordohet pas vdekjes dr. Flora Brovinës

FAQE 8-9





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI NIS HETIMIN PËR RASTIN E ARLINDA ZEKAJT, RAMADANI THOTË SE DO TË PUNOHET MBI BAZËN E FAKTEVE

FAQE 4



Komisioni Hetimor Parlamentar për rastin e Arlinda Zekajt nisi punën më 2 nëntor, katër ditë pasi Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e tij me 90 vota për. Kryetari i komisionit, Burim Ramadani, tha se hetimi do të mbështetet në fakte dhe prova, duke kërkuar që puna e tij të mos politizohet. Ai ka treguar se procesi do të zhvillohet në tri faza: mbledhjen e provave, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raportit përfundimtar. Ndërkaq në një deklaratë për medie, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka kërkuar që Prokuroria Speciale t'i hetojë veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve institucionalë në rastin e Arlinda Zekajt

ZULFAJ: KOSOVA KA HUMBUR 43.8 MILIONË EURO NGA PLANI I RRITJES I BE-së

F. 3



EKSPERTËT KËRKOJNË PAKT NACIONAL PËR ARSIMIN: GJENDJA NË SHKOLLA ËSHTË ALARMANTE

F. 7



AKTUALE



TRUMPI KËRCËNON IRANIN: MUND TË NA DUHET TA GODASIM FORT F. 2

SEANCA E KUVENDIT TË ENJTEN, NË REND DITE EDHE TRI PROJEKTLIGJE DHE RAPORTI I AUDITORIT F. 3

NË 37-VJETORIN E RËNIES, LIDERËT INSTITUCIONALË DHE PARTIAKË NDEROJNË HERONJTË AFRIM ZHITIA DHE FAHRI FAZLIU F. 5

EKONOMI



RRITEN TË HYRAT E DOGANËS SË KOSOVËS, MBI 186 MILIONË EURO TË MBLEDHURA GJATË TETORIT F. 6

ATK-ja PRANON MBI 3 000 DENONCIME NGA QYTETARËT PËR PARREGULLSI TATIMORE, RRITJE 42 PËR QIND F. 6

SPORT



MALISHEVA RUAN KREUN E TABELËS, PRISHTINA E NDJEK NGA AFËR F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

TRUMPI KËRCËNON IRANIN: MUND TË NA DUHET TA GODASIM FORT

UASHINGTON, 2 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump kërcënoi Iranin me sulme ajrore. Gjatë një tubimi elektoral, ai tha se ShBA-së mund t'i duhet ta godasë rëndë këtë vend, por nuk sqaroi se kur apo në çfarë rrethanash. "Arsyeja e vetme pse nuk e kam përfunduar punën me Iranin është se dua të tregohem i mirë", u tha ai mbështetësve më 1 nëntor, gjatë një tubimi në Ajova, vetëm dy ditë para zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA, më 3 nëntor. "Dua të përpiqem të shpëtoj sa më shumë jetë që të mundem... Por, në një moment, do të na duhet t'i godasim fort", shtoi ai.

Trumpi deklaroi më herët se, gjatë fundjavës, ka biseduar në telefon me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe se Irani ka qenë ndër temat e diskutuara.

Ai nuk dha hollësi të tjera.

Portali amerikan, "Axios", duke cituar burime amerikane dhe izraelite, raportoi se Netanyahu i ka kërkuar Trumpit t'i nisë sulmet kundër Iranit menjëherë pas zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA, më 3 nëntor.

Megjithatë, sipas raportimit, Trumpi është më i prirë t'u japë kohë negociatave që janë në zhvillim, për të parë nëse ato do të sjellin rezultate.

Tensionet në mes të Uashingtonit dhe Teheranit lidhen kryesisht me programin bërthamor iranian dhe shqetësimet e ShBA-së dhe Izraelit se Irani mund të zhvillojë armë bërthamore.

Teherani ka këmbëngulur se programi i tij ka vetëm qëllime paqësore dhe ka mohuar se synon të prodhojë armë të tilla.



Përplasja mes vendeve u përshkallëzua në shkurt të këtij viti, kur ShBA-ja dhe Izraeli nisën sulme ndaj Iranit, duke goditur objektiva ushtarake dhe të lidhura me programet bërthamore e raketore.

Irani u kundërpërgjigj me sulme ndaj Izraelit, bazave amerikane dhe objektivave në vende të tjera të rajonit.

Në prill u arrit një armëpushim, ndërsa në qershor palët nënshkruan një memorandum që parashihte negociata për përfundimin e konfliktit.

Megjithatë, marrëveshja nuk u zbatua plotësisht dhe luftimet vazhduan, duke lënë të pazgjidhura çështjet për programin bërthamor iranian, raketat balistike dhe sanksionet amerikane.

Përpjekjet diplomatike rifilluan ditët e fundit.

Sipas "Axios"-it, ndërmjetësuesit nga Katari kanë zhvilluar bisedime me zyrtarët iranianë, në përpjekje për ta hapur rrugën për negociata të drejtpërdrejta mes Uashingtonit dhe Teheranit.

Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araqchi, ka thënë se Irani është i përgatitur si për diplomaci, ashtu edhe për mbrojtje.

Ndërkohë, një zëdhënës i ushtrisë iraniane ka paralajmëruar se një luftë e re mund të zgjasë më shumë se përplasjet e mëparshme dhe se Trumpi nuk do të mund ta përcaktonte i vetëm kohëzgjatjen apo kushtet e përfundimit të saj.

ZELENSKY KUSHTËZON NDALIMIN E SULMEVE NDAJ RAFINERIVE RUSE ME RAKETAT PATRIOT

KIEV, 2 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se vendi i tij do t'i ndalonte sulmet ndaj rafinerive ruse të naftës - siç ka kërkuar presidenti amerikan, Donald Trump - nëse Shtetet e Bashkuara do ta furnizonin shpejt Ukrainën me raketa Patriot për mbrojtje ajrore.

Në një intervistë për "Fox News", më 1 nëntor, Zelensky tha se ka zhvilluar bisedime me presidentin amerikan dhe bashkëpunëtorët e tij për këtë çështje. "Ne u thamë se nuk mund të mos kundërpërgjigjemi pas sulmeve të Rusisë ndaj sektorit tonë energjetik, ndërkohë që Rusia vret njerëzit tanë dhe sulmon rrjetin elektrik, infrastrukturën e gazit, rafineritë dhe gjithçka tjetër", i tha ai gazetarit Trey Yingst.

"Ne thamë se, nëse doni që të mos i sulmojmë rafineritë ruse, atëherë edhe Rusia duhet t'i ndalë sulmet ndaj sistemit tonë energjetik. Alternativa tjetër është të na jepni raketa Patriot. Ne do t'i sigurojmë paratë. Nuk po kërkojmë vetëm ndihmë... Do të paguajmë për to", tha Zelensky. Ai shtoi se, nëse Shtetet e Bashkuara do t'i siguronin Ukrainës raketa Patriot për një muaj, Ukraina do t'i ndalte sulmet ndaj rafinerive ruse për të njëjtën periudhë.

Departamenti Amerikan i Shtetit njoftoi më 30 tetor se ka miratuar shitjen e raketave për sistemet e mbrojtjes ajrore Patriot për Ukrainën në vlerë prej 2.1 miliardë dollarësh.

Këto raketa, për të cilat Ukraina ka nevojë urgjente, synojnë ta forcojnë mbrojtjen e saj përballë sulmeve ajrore gjithnjë e më të shpeshta të Rusisë.

Megjithatë, Zelensky paralajmëroi se mund të duhen "disa vjet" derisa të mbërrijnë 500 raketat interceptuese. Në një postim në rrjetet sociale, Zelensky shkroi se "500 raketa interceptuese PAC-3 janë një numër i konsiderueshëm" dhe se ato mund të përbëjnë një paketë efektive mbrojtjeje gjatë këtij dimri. Por, ai shtoi se "dërgesat mund të fillojnë vetëm pas disa vjetësh". "Po u kërkojmë partnerëve tanë amerikanë të gjejnë një zgjidhje për këtë periudhë, kur rreziku është real dhe nevoja për përdorimin e raketave interceptuese PAC-3 është urgjente", tha presidenti



ukrainas.

Alex Plitsas, bashkëpunëtor në Këshillin Atlantik dhe ish-zyrtar i Pentagonit, tha se njoftimi për raketat Patriot është i rëndësishëm, por se nuk do t'u përgjigjet nevojave të menjëhershme të Ukrainës. Ai paralajmëroi se sulmet e vazhdueshme të Rusisë ndaj infrastrukturës energjetike synojnë t'i terrorizojnë civilët dhe ta detyrojnë Ukrainën të dorëzohet, duke e lënë popullsinë e saj të përballet me të ftohtin e dimrit.

Raketat interceptuese PAC-3 të sistemit amerikan Patriot janë ndër armët e pakta perëndimore që mund t'i rrëzojnë raketat balistike që Rusia i lëshon drejt qyteteve ukrainase.

Trumpi, i cili përballet me presion politik për shkak të rritjes së madhe të çmimeve të energjisë në ShBA, ka bërë thirrje për armëpushim në sektorin energjetik, duke kërkuar që Rusia dhe Ukraina t'i ndalin sulmet ndaj infrastrukturës së këtij sektori.

Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022 dhe u ka rezistuar thirrjeve për armëpushim.

Me afrimin e muajve të dimrit, që mund të jenë të ashpër, ajo ka shtuar sulmet ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës si dhe ndaj objekteve civile.

Ukraina është kundërpërgjigjur me sulme ndaj infrastrukturës energjetike ruse, për të cilën thotë se përdoret për ta mbështetur luftën e Moskës kundër saj.

Në mbarë Rusinë janë raportuar mungesa të karburanteve dhe radhë të gjata në pikat e furnizimit.

Ndërkohë, Ukraina dhe Rusia kanë raportuar sulme të dyshuara kibernetike ndaj sistemeve të tyre të paralajmërimit dhe informimit të qytetarëve.

Ende nuk dihet nëse incidentet kanë lidhje me njëri-tjetrin.

Forcat Ajrore të Ukrainës thanë se dyshojnë se sistemi i paralajmërimit për sulme ajrore është hakuar, por se funksionimi i tij është rikthyer në normalitet.

"Duket se dikush ka ndërhyrë në mënyrë të paautorizuar në aplikacionin për paralajmërimin e sulmeve ajrore. Ruani qetësinë dhe ndiqni njoftimet tona", thanë Forcat Ajrore ukrainase më 1 nëntor.

Një ditë më vonë, Ministria ruse e Situatave të Emergjencës njoftoi se aplikacioni i saj është goditur nga një sulm masiv kibernetik, duke u mundësuar sulmuesve t'u dërgonin qytetarëve informacione të rreme. "Aplikacioni i Ministrisë së Situatave të Emergjencës në Rusi është bërë cak i një sulmi masiv kibernetik, përmes të cilit sulmuesit kanë mundur të shpërndajnë informacione të rreme", njoftoi ministria në "Telegram".

Nuk ka prova që dy incidentet janë të lidhura.

Mediet ruse kanë raportuar edhe për disa sulme të tjera hakerësh ndaj faqeve të internetit në Rusi gjatë ditëve të fundit.

SULM I DYSHUAR KIBERNETIK GODET FRIGORIFERËT E DYQANEVE NË DISA VENDE EVROPIANE

BRUKSEL, 2 NËNTOR - Dhjetëra supermarkete në gjashtë vende evropiane u goditën nga një sulm i dyshuar kibernetik, i cili shkaktoi probleme në funksionimin e frigoriferëve dhe ngrirësve të tyre.

Rreth 40 supermarkete të rrjetit Delhaize në Belgjikë dhe Luksemburg u prekën nga incidenti, si dhe një numër më i vogël dyqanesh në Suedi, Irlandë, Holandë dhe Estoni.

Kompania belge, Sabcobel, e cila prodhon disa prej pajisjeve të prekura, tha se sistemet e shkrirjes së akullit në frigoriferë ishin aktivizuar nga distanca, duke shkaktuar rritjen e temperaturës brenda tyre.

Besohet se e njëjta metodë ishte përdorur edhe gjatë një incidenti muajin e kaluar, që preku qindra supermarkete në Francë.

Sipas raportimeve të medieve lokale, ushqime në vlerë prej miliona eurosh është dashur të hidhen për shkak të prishjes.

Drejtori ekzekutiv i Sabcobel-it, Stephan Moelans, kompania e të cilit menaxhon sistemet e ftohjes në rrjetin Delhaize, i tha agjencisë belge të lajmeve "Belga" se bëhet fjalë për një sulm kibernetik. Ai tha se kompania kishte punuar gjatë gjithë natës dhe mëngjesit për t'i shkëputur pajisjet e prekura nga rrjeti.



Moelans shpjegoi se, pas sulmit në Francë në fillim të tetorit, kompania kishte nisur përpjekjet për t'i mbrojtur frigoriferët e klientëve nga kjo dobësi e sigurisë.

Megjithatë, sipas tij, zgjidhja kërkon ndërhyrje fizike në pajisje dhe jo vetëm përditësime të programeve kompjuterike.

"Zgjidhja më e thjeshtë është që frigoriferët të menaxhohen përmes një lidhjeje të sigurt interneti. Shumica e klientëve tanë kaluan në këtë mënyrë pas sulmit në Francë", shtoi ai.

Ende nuk dihet se kush qëndron pas sulmit të dyshuar.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

ZULFAJ: KOSOVA KA HUMBUR 43.8 MILIONË EURO NGA PLANI I RRITJES I BE-SË

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kosova ka humbur 43.8 milionë euro nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, pasi nuk ka arritur t'i përmbushë gjashtë nga 13 hapat e reformave, afati i të cilave ishte deri në qershor të këtij viti, si pasojë e bllokadës politike. Kështu ka bërë me dije kryenegociatori i Kosovës me BE-në dhe koordinatori kombëtar për Planin e Rritjes, Jeton Zulfaj, gjatë raportimit në Komisionin për Integrim Evropian.

Zulfaj ka thënë se nga 13 hapat e paraparë në periudhën shtesë deri në qershor 2026, Kosova ka arritur t'i zbatojë shtatë, ndërsa gjashtë të tjerë nuk janë përmbushur brenda afatit të përcaktuar. Ai ka bërë me dije se vlera e përgjithshme e Planit të Rritjes për Kosovën është 882.6 milionë euro, ku dy të tretat e kësaj shume janë kredi të lidhura me 111 hapa reformash, të cilat duhet të përmbushen deri në fund të gushtit të vitit të ardhshëm.

"Siç e dini, Plani i Rritjes për Kosovën kap vlerën e 882.6 milionë eurove, ku dy të tretat janë kredi të lidhura me 111 hapa reformash, deri në fund të gushtit të vitit që vjen. Më 15 korrik të këtij viti kemi dorëzuar kërkesën e parë për pagesë, me 20 hapa të zbatuar, në vlerë prej 153.4 milionë eurosh. Shuma përfundimtare do të varet nga vlerësimi i Bashkimit Evropian, për të cilin presim që në këto ditë të para të nëntorit të bëhet e ditur se sa do të jetë shuma e saktë. Nga 13 hapa në periudhën shtesë deri në qershor 2026, zbatuam shtatë, ndërsa gjashtë jo. Llogaritet se kanë humbur mbi 40 milionë euro, ose më saktë 43.8 milionë euro, të cilat kanë humbur për shkak të mosrealizimit të tyre brenda afatit të qershorit", tha ai.

Zulfaj ka theksuar se shumica e reformave të papërmbushura kanë kërkuar miratimin e projektligjeve në Kuvend, në një kohë kur ky institucion ishte i shpërndarë. Megjithatë, ai ka thënë se këto reforma janë rikthyer në proces dhe synohet të miratohen gjatë këtij viti. Ato përfshijnë ligjet për energjinë dhe falimentimin, pakon ligjore për drejtësinë, si dhe strategjinë kundër krimit të organizuar.

"Shumica e tyre kanë kërkuar miratimin e projektligjeve në Kuvend, në një kohë kur Kuvendi, siç e dini, ishte i shpërndarë. Megjithatë, të gjitha këto reforma janë në rrugë për t'u zbatuar këtë vit. Ligji për energjinë, ai për falimentimin, pakoja ligjore për drejtësinë dhe strategjia kundër krimit të organizuar. Pra, të gjitha reformat, sepse procesi i tërësimit në BE është proces reformator. Të gjitha reformat që nuk kanë arritur të përmbushen brenda afatit të qershorit janë kthyer sërish në proces, fillimisht në qeveri e më pas në Kuvend, në mënyrë që të mos humbet asnjë reformë, edhe nëse mjetet nuk arrijnë të përfitohen me kohë", tha ai.

Kryenegociatori ka paralajmëruar se deri më 31 dhjetor Kosova duhet t'i përmbushë edhe 22 hapa të tjerë në vlerë prej 131.5 milionë eurosh. Sipas tij, dhjetë akte duhet të miratohen në Kuvend, ndërsa një pjesë e projektligjeve pritet të procedohen nga qeveria. "Tani kemi përpara vetes 22 hapa në vlerë prej 131.5 milionë eurosh, që kanë afat deri më 31 dhjetor. Pra, kanë mbetur edhe 59 ditë. Dhjetë akte duhet të miratohen në këtë Kuvend. Projektligji për inovacion dhe ndërmarrësi tashmë është në Kuvend, kurse të tjerat qeveria do t'i sjellë për miratim.



Varësisht nga vonesat që mund të shkaktohen edhe nga Komisioni Evropian në dërgimin e komenteve, pasi pjesë e procesit të përmbushjes së hapave është edhe konsultimi me Bashkimin Evropian, secili hap, sidomos kur bëhet fjalë për ligjet, kërkon që, përveç konsultimeve publike që zhvillojmë ne, të bëhen edhe konsultime me BE-në. Komisioni Evropian kërkon rreth 90 ditë kohë për t'i kthyer këto komente, gjë që shkakton vonesa të tjera në procedimin e ligjeve.

Besoj se deri në fund të nëntorit duhet të procedohen projektligji për inovacion, i cili tashmë është në Kuvend, projektligji për prokurimin publik dhe ai për partneritetin publiko-privat", tha Zulfaj.

Opozita kritikon qeverinë për humbjen e 43.8 milionë eurove nga Plani i Rritjes

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës lidhur me humbjen e 43.8 milionë eurove nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, duke ia atribuuar asaj përgjegjësinë për mosrealizimin e reformave të kërkuara.

Bajrami ka thënë se Kosova nuk ka arritur t'i përmbushë gjashtë nga 13 hapat e reformave, afati për të cilët ishte qershori i këtij viti. Ajo ka rikujtuar edhe humbjen e 613.4 milionë eurove gjatë mandatit të kaluar, për të cilat ka fajësuar qeverinë, duke përmendur edhe masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. "43.8 milionë euro Kosova ka humbur nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, pasi nuk ka arritur t'i përmbushë gjashtë nga 13 hapat e reformave për të cilat afati i fundit ishte qershori i këtij viti. Mos harroni se në mandatin e kaluar Kosova ka humbur 613.4 milionë euro, sepse falë Qeverisë për 960 ditë kemi qenë nën masat ndëshkuese të BE-së", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Edhe Aleanca e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës lidhur me humbjen e 43.8 milionë eurove nga fondet e Bashkimit Evropian në kuadër të Planit të Rritjes.

Në një reagim publik, Aleanca e ka cilësuar këtë si dëshmi të radhës të dështimit të qeverisë, duke e akuzuar atë për mungesë vizioni, pune dhe llogaridhënieje. Sipas Aleancës, në një kohë kur çmimet po rriten dhe bizneset po përballen me vështirësi, humbja e këtyre fondeve përbën një goditje për zhvillimin ekonomik dhe të ardhmen e vendit. "Të humbësh miliona euro fondesh pa kthim në një nga vendet më të varfra të Evropës nuk është gabim apo vonesë burokratike, është papërgjegjshmëri absolute dhe goditje e drejtpërdrejt ndaj të ardhmes së Kosovës", thuhet në reagimin e Aleancës.

SEANCA E KUVENDIT TË ENJTEN, NË REND DITE EDHE TRI PROJEKTLIGJE DHE RAPORTI I AUDITORIT

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që seanca e radhës plenare të mbahet të enjten, në orën 12:00. Kështu ka bërë me dije kryetarja e Kuvendit të Kosovës përmes një postimi, ku ka njoftuar se deputetët do të shqyrtojnë në lexim të parë tri projektligje që lidhen me sigurinë e qytetarëve, bujqësinë dhe cilësinë e ushqimit si dhe raportin e Auditorit për buxhetin e vitit të kaluar. Ajo ka njoftuar se ka filluar punën Komisioni Hetimor Parlamentar për rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt, duke theksuar se qëllimi i tij është t'i zbardhë dështimet institucionale dhe t'i identifikojë përgjegjësit.

Kryetarja e Kuvendit ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar plotësisht me komisionin, ndërsa ka kërkuar që të gjithë zyrtarët e ftuar të paraqiten dhe të japin përgjigje. Ajo ka vlerësuar pezullimin e kryeprokurores së Pejës, prokurores së rastit dhe zyrtarëve policorë, por ka theksuar se përgjegjësia nuk duhet të përfundojë me kaq. Sipas saj, shqetësuese mbetet mungesa e masave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe komuna e Pejës ndaj zyrtarëve të tyre që nuk e kanë kryer detyrën. Ajo ka kërkuar nga Prokuroria Speciale që, pa vonesë, t'i hetojë të gjithë zyrtarët që nuk vepruan ose vepruan në kundërshtim me detyrën në rastin e Arlinda Zekajt.

Ndërkaq, ka bërë me dije se



Komisioni Hetimor do ta përfundojë punën me një raport, i cili do t'i përcillet Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Në fund, kryetarja e Kuvendit ka theksuar se rasti i Arlinda Zekajt dëshmoi se ligjet nuk mjaftojnë nëse nuk zbatohen, duke paralajmëruar se do t'u kërkojë komisioneve parlamentare të mbikëqyrin nga afër zbatimin e tyre. "Çdo grua që i kërkon shtetit mbrojtje duhet ta marrë atë pa vonesë dhe pa pasur nevojë ta kërkojë dy herë", ka theksuar ajo.

KUVENDI NIS HETIMIN PËR RASTIN E ARLINDA ZEKAJT, RAMADANI THOTË SE DO TË PUNOHET MBI BAZËN E FAKTEVE

Komisioni Hetimor Parlamentar për rastin e Arlinda Zekajt nisi punën më 2 nëntor, katër ditë pasi Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e tij me 90 vota për. Kryetari i komisionit, Burim Ramadani, tha se hetimi do të mbështetet në fakte dhe prova, duke kërkuar që puna e tij të mos politizohet. Ai ka treguar se procesi do të zhvillohet në tri faza: mbledhjen e provave, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raportit përfundimtar. Ndërkaq në një deklaratë për medie, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka kërkuar që Prokuroria Speciale t'i hetojë veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve institucionalë në rastin e Arlinda Zekajt



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, kërkoi që Prokuroria Speciale t'i hetojë veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve institucionalë në rastin e Arlinda Zekajt, e cila u vra më 25 tetor në Pejë. Kërkesa e saj erdhi më 2 nëntor, në ditën kur nisi punën Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e përgjegjësisë institucionale në këtë rast.

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Haxhiu tha se hetimi parlamentar duhet të shoqërohet me veprime konkrete nga organet e drejtësisë. "Do të duhej që Prokuroria Speciale të jetë e angazhuar për mosveprimet apo veprimet e gabuara të secilit zyrtar", tha ajo. Sipas Haxhiut, Komisioni Parlamentar do të jetë një mekanizëm shtesë për shqyrtimin e rastit dhe përgatitjen e një raporti që do t'i përcillet prokurorisë kompetente. Ajo kërkoi që të gjithë personat që do të thirren për të dëshmuar para komisionit, t'u përgjigjen kërkesave të tij.

Haxhiu përshëndeti pezullimin e 11 zyrtarëve policorë, të kryeprokurores së Pejës dhe të prokurores që kishte trajtuar rastin, por kritikoi institucionet e tjera për mungesë veprimi. "Mbetem me shqetësim se pse Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk ka vepruar dhe as komuna e Pejës", tha ajo, duke kërkuar masa edhe ndaj zyrtarëve komunalë përgjegjës për mirëqenien sociale. "Ky rast duhet të na shërbejë që asnjëherë në të ardhmen të mos kemi zyrtarë që nuk e kryejnë detyrën e tyre", shtoi Haxhiu.

Çfarë do të hetojë komisioni?

Komisioni Hetimor Parlamentar për rastin e Arlinda Zekajt nisi punën më 2 nëntor, katër ditë pasi Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e tij me 90 vota për. Hetimi do të përqendrohet në veprimet dhe mosveprimet e institucioneve që kanë trajtuar rastin e Zekajt, por edhe më gjerësisht në trajtimin institucional të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në familje.

Kryetari i komisionit, Burim Ramadani, tha se hetimi do të mbështetet në fakte dhe prova, duke kërkuar që puna e tij të mos politizohet. Sipas Ramadanit, procesi do të zhvillohet në tri faza: mbledhjen e provave, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.

Komisioni përbëhet nga 11 deputetë të pushtetit, opozitës dhe komuniteteve joshumicë ndërsa, sipas Ligjit për Hetim Parlamentar, ka gjashtë muaj kohë për t'ia paraqitur Kuvendit raportin përfundimtar.

"Komisioni Hetimor do të punojë mbi bazën e fakteve, dokumenteve, dëshmive dhe përgjegjësive konkrete. Rasti i Arlinda Zekajt është një alarm serioz për të gjithë sistemin institucional. Komisioni nuk është farsë. Komisioni nuk do të bëjë raport politik, por vetëm në fakte. Do t'i shqyrtojmë të gjitha hallkat institucionale. Asnjë institucion dhe asnjë individ nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë ligjore. Kërkoj nga të gjitha institucionet të jenë plotësisht bashkëpunuese. Le t'ia nisin përgatitjes së dokumenteve që do të kërkohen. Neni 19 dhe Neni 20 i Ligjit për Hetim Parlamentar përcaktojnë qartësisht se të gjithë të intervistuarit si dëshmitarë janë të detyruar të bashkëpunojnë me Komisionin. Pra, nuk është dëshirë apo zgjedhje, por është obligim ligjor. Në të kundërtën, vlejnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kundër dëshmitarit që nuk bashkëpunon me Komision. Shpresoj se asnjë nga ta nuk do të refuzojë apo tentojë të fsheh nga Komisioni", ka thënë Ramadani.

Ai ka theksuar se qëllimi i komisionit nuk është të prodhojnë një raport politik. "Qëllimi ynë është ta zbardhim të vërtetën institucionale, t'i identifikojmë përgjegjësitë dhe t'i propozojmë ndryshime që mund të shpëtojnë jetë. Komisioni, sikurse e dini, ka tri faza të punës së vet. Neni 14 i Ligjit për Hetim Parlamentar përcakton shprehimisht se puna e komisionit ndahet në tri faza: 1. Faza e hetimeve (pra mbledhja e provave); 2. Vlerësimi i hetimeve (pra analizimi i provave); 3. Përgatitja e raportit final", ka deklaruar Ramadani.

Mbledhja e radhës e këtij komisioni u caktua të mbahet të premten ku do të diskutojnë mbi planin e veprimit, e ku u kërkuan edhe raportet e Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Punëve të Brendshme me qëllim që të ndihmojnë në qartësimin e veprimeve.

Arlinda Zekaj u vra më 25 tetor në Vitomiricë të Pejës, ndërsa për vrasjen dyshohet ish-kunati i saj. Para se të vritej ajo kishte kërkuar mbrojtje nga institucionet, duke paralajmëruar se jeta e saj ishte në rrezik.

Gjetjet preliminare të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) nxorën në pah një varg lëshimesh në trajtimin e rastit. Sipas IPK-së, policia nuk kishte dokumentuar ekzekutimin e një urdhri mbrojtës të lëshuar më 7 shtator, ndërsa një urdhër tjetër, i 16 tetorit, ishte zbatuar me gjashtë ditë vonesë, pas ndërhyrjes së Inspektoratit.

Po ashtu, drejtuesit policorë në Pejë nuk kishin trajtuar një kërkesë të hetuesit, të dërguar më 23 tetor, për rivlerësimin e rastit dhe shtimin e masave të sigurisë për Zekajn.

Pas vrasjes, 11 zyrtarë policorë u pezulluan nga detyra, përfshirë drejtues të Policisë në Pejë.

Masa të ngjashme u ndërmorën edhe ndaj kryeprokurores së Pejës dhe prokurores që kishte trajtuar rastin.

Më 30 tetor drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, dha dorëheqje, duke e cilësuar vendimin si akt i përgjegjësisë morale.

Vrasja nxiti protesta në disa qytete të Kosovës dhe kërkesa për llogaridhënie nga institucionet që kishin trajtuar paralajmërimet e viktimës.

33 RASTE TË SULMEVE NDAJ GAZETARËVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2026, AGK-JA KËRKON DREJTËSI

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Me rastin e 2 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Dhënien Fund të Pandëshkueshmërisë së Krimeve ndaj Gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë t'i trajtojnë me prioritet rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe formave të tjera të dhunës ndaj gazetarëve dhe punonjësve medialë.


AGK-ja u ka kërkuar Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe institucioneve gjyqësore që të ndërmarrin hapa konkretë për hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave.

Sipas të dhënave të publikuara nga AGK-ja, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 53 raste të sulmeve dhe incidenteve ndaj gazetarëve, por vetëm 12 prej tyre figuronin në evidencat zyrtare të Policisë së Kosovës.

Situata ka vazhduar të jetë shqetësuese edhe gjatë vitit 2025, kur AGK-ja ka dokumentuar gjithsej 69 raste. Megjithatë, deri më 31 tetor të atij viti vetëm për 12 raste kishte informacione zyrtare nga policia apo prokuroria. "Ndërkohë, nga 1 janari deri më 31 tetor 2026, AGK-ja ka regjistruar 33 raste të tjera", thuhet në njoftim.

Nga rastet për të cilat kishte informacione institucionale gjatë vitit 2025, dy kishin përfunduar me vendime dënuese, ndërsa dhjetë të tjera vazhdonin të ishin në procedurë.

AGK-ja ka vlerësuar se ekziston një hendek shqetësues ndërmjet numrit të incidenteve të raportuara dhe rasteve që marrin trajtim nga institucionet. "Dallimet e mëdha ndërmjet evidencave, mungesa e të dhënave të harmonizuara dhe informacionet e kufizuara për ecurinë e procedurave e vështirësojnë vlerësimin e përgjigjes institucionale dhe të shkallës së pandëshkueshmërisë", thuhet në



reagim.

Asociacioni ka evidentuar gjithashtu vonesa në trajtimin e rasteve, mungesë transparence për procedurat hetimore dhe gjyqësore, si dhe nevojën për koordinim më të mirë ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave. Shqetësim i veçantë, sipas AGK-së, mbeten kërcënimet serioze, sulmet fizike, ngacmimet e vazhdueshme dhe fushatat e organizuara të frikësimit ndaj gazetarëve, përfshirë sulmet me bazë gjinore ndaj grave gazetare.

Në këtë drejtim, AGK-ja ka kërkuar që institucionet kompetente t'i trajtojnë pa vonesa rastet e raportuara, t'i rishikojnë rastet e pazgjidhura nga vitet e kaluara dhe të sigurojnë hetime të pavarura dhe efektive.

Po ashtu, ka kërkuar publikimin e të dhënave periodike për rastet e raportuara, hetimet, aktakuzat dhe vendimet përfundimtare, si dhe ofrimin e masave mbrojtëse për gazetarët që përballen me kërcënime. "Siguria e gazetarëve nuk mund të garantohet vetëm përmes reagimeve publike pas incidenteve. AGK-ja kërkon veprime të vazhdueshme institucionale, hetime efektive dhe vendime gjyqësore të bazuara në ligj", theksohet në njoftim.

Në fund, Asociacioni ka rikujtuar se pandëshkueshmëria e sulmeve ndaj gazetarëve nuk cenon vetëm sigurinë e tyre personale dhe profesionale, por edhe lirinë e medias dhe të drejtën e qytetarëve për t'u informuar. "Drejtësia për gazetarët e sulmuar nuk duhet të mbetet kërkesë e përsëritur çdo 2 nëntor, por përgjegjësi e përditshme e institucioneve të drejtësisë", përfundon reagimi i AGK-së.

NË 37-VJETORIN E RËNIES, LIDERËT INSTITUCIONALË DHE PARTIAKË NDEROJNË HERONJTË AFRIM ZHITIA DHE FAHRI FAZLIU



PRISHTINË, 2 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, e shoqëruar nga kryeministri Albin Kurti, ka bërë homazhe të hënën te Varrezat e Dëshmorëve në Velani, në 37-vjetorin e rënies së dëshmorëve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu.

Presidentja Justina Shiroka-Pula nderoi jetën dhe veprën e dy atdhetarëve, duke theksuar se sakrifica e tyre mbetet pjesë e pandashme e historisë së përpjekjes së Kosovës për liri. "Ata nuk e pritën ditën e lirisë, por dhanë jetën që kjo ditë të vinte. Emrat e tyre mbeten të lidhur përgjithmonë me këtë liri dhe me përgjegjësinë tonë për ta bërë Kosovën siç deshën dhe për të cilën u flijuan", ka theksuar presidentja Shiroka-Pula.

"Bashkë me presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Justina Shiroka-Pula, vendosëm lule të freskëta dhe bëmë homazhe te varret e Afrim Zhitisë dhe të Fahri Fazliut, të cilët para 37 vjetëve ranë heroikisht në ballafaqim të armatosur e të pabarabartë me forcat e shtetit serbo-jugosllav. Në vitin 1989 i kishim Afrimin e Fahriun, e pesë vjet para tyre, në mes të viteve '80, e kishim Rexhep Malën e Nuhi Berishën. Ishin këto përballje në të cilat rënia heroike e veprimtarëve intelektualë dhe patriotëve idealistë, bëhej ngritje e vetëdijes dhe e organizimit të shqiptarëve. Ishte kjo dekada kur shqiptarët nën ish-Jugosllavi, përbënin 1/8 e popullsisë së gjithëmbarshme, por rreth 80 për qind të të gjithë ish-të burgosurve politikë ishin shqiptarë", ka theksuar kryeministri Kurti.

Ai ka shtuar se Afrimi e Fahriu, edhe punuan, edhe luftuan, edhe u angazhuan e kontribuuan, për çlirimin e Kosovës, për lirinë e popullit dhe për bashkimin e përparimin e tij. "Ata tani prehen të qetë së bashku me heronjtë tanë të tjerë, Ilir Konushevcin, doktor Hazir Malën, Agron Rrahmanin, Bahri Fazliun, e në mes të gjithë këtyre, simbolin e qëndresës shqiptare, bacë Adem Demaçin. Duke lartësuar Republikën dhe kombin tonë, duke mbrojtur integritetin territorial, duke ruajtur sovranitetin shtetëror, duke rritur ekonominë dhe forcuar ushtrinë, duke u shërbyer qytetarëve e shoqërisë, ne u përmbahemi idealeve të dëshmorëve të kombit", ka thënë Kurti.

Po ashtu, nderime kanë bërë edhe përfaqësuesit e partive politike dhe kryetarë komunash. Ish-kryetari i Aleancës, Ramush Haradinaj, ka thënë se heronjtë e kombit, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, i takojnë brezit të hershëm të lëvizjeve për liri, atdhetarëve që ranë për çlirimin e Kosovës. "Afrimi dhe Fahriu janë atdhetarët e hershëm që me jetën dhe veprën e tyre motivuan brezat që në fundshekullin e kaluar t'i japin fund robërisë përmes luftës sonë çlirimtare", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka vlerësuar qëndresën dhe veprën e Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, duke theksuar se sakrifica e dy heronjve u bë pjesë e vetëdijes së një brezi që do ta vazhdonte rrugën drejt lirisë. Ai ka thënë se madhështia e veprës së tyre qëndron në bashkimin e bindjes, guximit dhe përgjegjësisë.

Rama ka theksuar se Prishtina e ruan vendin e rënies së tyre si pjesë e historisë më të çmuar, ndërsa ka nënvizuar se Kosova e ka për detyrë që veprën e tyre ta përcjellë te brezat e rinj, përmes edukimit dhe përgjegjësisë për ndërtimin dhe mbrojtjen e shtetit.

Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se Afrimi dhe Fahriu rinisë shqiptare ia dëshmuan rrugën e lirisë me jetën e tyre dhe rënien heroike, më 2 nëntor 1989. "Përjetësisht në zemrat e atdhetarëve. Lavdi heronjve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu!", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

Me rastin e 37-vjetorit të rënies së heronjve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, homazhe te varret e tyre kanë bërë edhe deputetët e PDK-së, Përparim Gruda dhe Arian Tahiri. "37 vjet më parë, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu dhanë jetën për ëndrrën e një Kosove të lirë. Sot i kujtojmë me respekt, krenari e mirënjohje të përjetshme. Lavdi për jetë e mot!", ka shkruar Gruda në "Facebook".

Më 2 nëntor 1989, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu në Bregun e Diellit në Prishtinë, qëndruan deri në fund përballë forcave serbe. Qëndresa e tyre u bë pjesë e vetëdijes së një brezi që do ta vazhdonte rrugën drejt lirisë.



ATK-ja pranon mbi 3 000 denoncime nga qytetarët për parregullsi tatimore, rritje 42 për qind

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka pranuar 3 054 denoncime nga qytetarët për parregullsi tatimore gjatë periudhës janar-shtator 2026. Sipas njoftimit të ATK-së, kjo shifër paraqet rritje 42 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur kishte pranuar 2 150 denoncime, apo 904 më pak se këtë vit.

ATK-ja vlerëson se kjo rritje dëshmon për një angazhim më të madh të qytetarëve dhe forcim të bashkëpunimit me institucionin në luftimin e shmangies tatimore dhe identifikimin e parregullsive. Në njoftim theksohet se qytetarët janë partnerë të rëndësishëm të ATK-së dhe se çdo raportim kontribuon në ndërtimin e një sistemi tatimor më të përgjegjshëm dhe më të drejtë. "Së bashku për përgjegjësi tatimore dhe drejtësi për të gjithë!", thuhet në mesazhin e ATK-së.



KURTI: PËRMES PLANIT NJË MILIARD EURO SYNOJMË ZËVENDËSIMIN E IMPORTEVE ME PRODHIM VENDOR

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se qeveria synon ta rrisë prodhimin vendor dhe t'i zëvendësojë importet përmes Planit Një Miliard Euro.

Në një postim në "Facebook", Kurti ka bërë me dije se në kuadër të aktivitetit "Data4Breakfast", gjatë tri mëngjeseve të punës, kanë dëgjuar përfaqësues të bizneseve nga sektorët e tregtisë me pakicë, përpunimit të ushqimit dhe prodhimit të pijeve joalkoolike. Ai ka theksuar se sektori i pijeve përfaqëson një nga shembujt e potencialit prodhues dhe eksportues të Kosovës, ndërsa ka vlerësuar se zgjerimi i mëtejshëm i këtij sektori kërkon kushte që u mundësojnë kompanive të investojnë, të prodhojnë dhe të depërtojnë në tregje të reja.

Kurti ka thënë se, krahasuar me vitin 2021, eksporti është rritur për 27,5 për qind, duke shtuar se kjo rritje është katër herë më e shpejtë se ajo e importit. Ai ka përmendur edhe rritjen e pagës minimale nga 170 në 500 euro si dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe të punësimit të të rinjve. Sipas Kurtit, pagat më të mira dhe shtimi i vendeve të punës ndikojnë edhe në rritjen e fuqisë blerëse për produktet vendore.

"Prandaj, në treg fitohet me produkt e cilësi, ndërsa duhet të ketë zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe rregulla të barabarta për të gjithë", ka shkruar Kurti.

Në fund, ai ka paralajmëruar se në vitin 2027 do të rikthehen në të njëjtat takime për t'i vlerësuar së bashku rezultatet e arritura.



PESË KOMUNAT E DUKAGJINIT BASHKOJNË FORCAT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE ME MBËSHTETJEN E GJERMANISË

JUNIK, 2 NËNTOR - Kryetarët e komunave të rajonit të Dukagjinit janë takuar në Junik me përfaqësues të institucioneve gjermane për të diskutuar përparimin dhe sfidat në përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave në pesë komunat e rajonit.



Në takim morën pjesë dr. Micong Klimes, zyrtar i Zyrës për Kosovën në Ministrinë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), si dhe përfaqësues të Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, GIZ-it dhe KfW-së. Diskutimet u përqendruan në prioritetet për krijimin e një sistemi të përbashkët, më efikas dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave.

Me mbështetjen e Qeverisë së Gjermanisë, përmes GIZ-it, pesë komunat kanë hartuar një Plan Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, i cili synon të krijojë një qasje të koordinuar mes komunave dhe t'i përmirësojë shërbimet për qytetarët, shkruan "Telegrafi".

Pas takimit përfaqësuesit zhvilluan edhe një vizitë në terren në lagjen "Agim Ramadani" në Junik, ku panë nga afër zbatimin e iniciativave të parapara në planin ndërkomunal.

Projekti synon të përfshijë më shumë familje në ndarjen e mbeturinave që në burim, duke nxitur përgjegjësinë qytetare dhe duke kontribuar në krijimin e lagjeve më të pastra dhe një mjedisi më të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi ndërmjet pesë komunave dhe institucioneve gjermane synon që menaxhimi i mbeturinave të mos trajtohet vetëm si përgjegjësi individuale e secilës komunë, por si një sistem i përbashkët rajonal, me planifikim dhe koordinim më të mirë.

RRITEN TË HYRAT E DOGANËS SË KOSOVËS, MBI 186 MILIONË EURO TË MBLEDHURA GJATË TETORIT

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Dogana e Kosovës ka mbledhur 186.6 milionë euro të hyra gjatë muajit tetor 2026, duke shënuar rritje 5.9 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas buletinit mujor të publikuar nga Dogana e Kosovës, në tetor të vitit 2025 të hyrat kishin arritur në 176.2 milionë euro, ndërsa këtë vit shuma është rritur në 186.6 milionë euro.

Përveç rritjes së të hyrave, gjatë muajit tetor janë shënuar edhe disa zhvillime të tjera në aktivitetin doganor.

Një ndër to ishte realizimi i eksportit të parë në pikën kufitare Dheu i Bardhë, pas hyrjes në zbatim të plotë të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë Kosovë-EFTA, e cila synon të krijojë mundësi të



reja për bizneset e Kosovës.

Po ashtu, Dogana ka njoftuar për një operacion të Sektorit të Antikontrabandës, gjatë të cilit janë ndaluar 121 telefona celularë pa dokumentacionin përkatës.

Një tjetër zhvillim ishte organizimi i punëtorisë së parë ndërkombëtare për vlerësimin doganor në Kosovë, në kuadër të programit Customs Programme, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të DG TAXUD.

Në buletinin mujor, Dogana e Kosovës ka theksuar përkushtimin për forcimin e kontrolleve doganore, luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme.


Institucioni ka bërë me dije se do ta vazhdojë angazhimin për mbrojtjen e interesave financiare të Republikës së Kosovës.

Partneritet i ri në mbështetje të bizneseve për tranzicionin e gjelbër

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Oda Ekonomike e Kosovës dhe Habitat L.L.C. kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për t'i mbështetur bizneset në zbatimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) si dhe në përdorimin e teknologjive klimatike.

Bashkëpunimi përfshin trajnime, shkëmbim ekspertize dhe zgjidhje digjitale për matjen, menaxhimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve serrë, përfshirë platformën Karbon360° të zhvilluar nga Habitat.

Ky partneritet synon t'i ndihmojë kompanitë anëtare ta përmirësojnë performancën mjedisore, të përgatiten për kërkesat e tregut të Bashkimit Evropian dhe ta rritin konkurrueshmërinë.



EKSPERTËT KËRKOJNË PAKT NACIONAL PËR ARSIMIN: GJENDJA NË SHKOLLA ËSHTË ALARMANTE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 2 NËNTOR - Financimi i pamjaftueshëm, sfidat në zbatimin e kurrikulës, cilësia e mësimdhënies dhe ndërlidhja e shkollimit me tregun e punës janë ndër shqetësimet kryesore të ngritura gjatë tryezës së organizuar nga Komisioni Parlamentar për Arsim, ku u diskutua për sfidat dhe prioritetet e arsimit parauniversitar.

Përderisa përfaqësuesit institucionalë kërkuan bashkëpunim më të gjerë për përmirësimin e sistemit arsimor, ekspertët vlerësuan se gjendja është alarmante dhe kërkon një pakt nacional për arsimin.

Në diskutimin e mbajtur të hënën, zëvendësministri i Arsimit, Përparim Kryeziu, theksoi se strategjia arsimore duhet të trajtohet si përgjegjësi e përbashkët e institucioneve, komunave, shkollave, shoqërisë civile dhe prindërve.

Ai bëri me dije se mësimi tërëditor aktualisht zbatohet vetëm në Prishtinë dhe Kamenicë, ndërsa zgjerimi i tij kërkon përgatitje infrastrukturore dhe përshtatje të kurrikulës. "Aktualisht janë dy komuna që po e zbatojnë këtë politikë. Është komuna e Prishtinës dhe e Kamenicës. Ne duhet të sigurohemi që t'i marrim mësimet nga këto dy komuna, në mënyrë që të mos i përsërisim gabimet e njëjta. Gabime të tjera mund të bëjmë, por të njëjtat nuk kemi nevojë t'i përsëritim. Për këtë, padyshim që do të kemi komunikim dhe bashkëpunim me komunat. Nëse pajtohemi se arsimi tërëditor është mënyra më e mirë e organizimit në shkolla, atëherë duhet të flasim edhe për infrastrukturën, por edhe për kurrikulën që e mbështet një politikë të tillë. Ne tashmë jemi duke punuar në hartimin e një protokolli për ndërtimin e shkollave, të cilit duhet t'i përmbahen të gjitha investimet e reja, si dhe projektet për krijimin apo përshtatjen e infrastrukturës ekzistuese", tha Kryeziu.

Duke folur për arsimin profesional, ai njoftoi se aktualisht ekzistojnë 16 profile të arsimit dual dhe se pritet të shtohen edhe të tjera. Kryeziu kërkoi bashkëpunim më të ngushtë me bizneset, në mënyrë që shkollat profesionale t'u përgjigjen nevojave të tregut të punës. "Na duhet bashkëpunim më i afërt me sektorin privat, për shkak se ata janë, si të themi, dera e parë e pranimit dhe adresa e parë e tregut të punës. Investimet në shkolla duhet të bëhen në atë drejtim që shkollat t'u ngjajnë sa më shumë ndërmarrjeve dhe më pak shkollave konvencionale që i njohim ne", u shpreh ai.

Megjithatë, drejtori i Arsimit në Prishtinë, Arianit Elshani, paralajmëroi se zgjerimi i mësimit tërëditor paraqet sfidë serioze financiare për komunat, veçanërisht sa i përket punësimit të mësimdhënësve.

Ndërkaq, drejtori i ETA-s, Agon Ahmeti, kërkoi një marrëveshje gjithëpërfshirëse që tejkalon interesat politike, duke paralajmëruar se situata në arsim kërkon ndërhyrje urgjente. Ai përmendi edhe studimet, sipas të cilave, 85 për qind e nxënësve nuk e kanë të zhvilluar mendimin kritik. "Ka ardhur koha që ta shpallim një pakt nacional për arsimin, që i tejkalon interesat e ngushta, qoftë partiake apo të çfarëdo grupacioni tjetër që ka pushtet. Situata në arsim është urgjente. Më jepet përshtypja se edhe shpallja e arsimit si prioritet qeveritar nuk mjafton. Gjendjen e kemi alarmante, nëse u besojmë këtyre studimeve. Nuk e di nëse Kosova e ka një vizion se çfarë qytetarësh dëshiron të ketë", tha Ahmeti.

Edhe kryetari i Komisionit për Arsim dhe Shkencë në Kuvendin e Kosovës, Enver Hoxhaj, vlerësoi se Kosova po përballet me një krizë të vazhdueshme në arsim. Përgatitja e mësimdhënësve, zbatimi i kurrikulës dhe rezultatet në testin ndërkombëtar PISA ishin disa nga çështjet që Hoxhaj vuri në theks.

"Debat i gjerë është çështja e PISA-s, e cila, jo vetëm pse është një vlerësim i jashtëm, por edhe sepse i shpërfaq në mënyrë serioze problemet në fushën e arsimit. Po ashtu, çështje të rëndësishme janë edhe tekstet shkollore, që mbeten një problem i vazhdueshëm, ndërlidhja e arsimit me tregun e punës dhe Këshilli i Prindërve", tha ai.

Në anën tjetër, Osman Buleshkaj nga Instituti Pedagogjik i Kosovës ngriti shqetësimin për mënyrën e shpërndarjes së buxhetit për arsim, duke theksuar se pjesa më e madhe e mjeteve shpenzohet për paga, ndërsa investimet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies mbeten sfidë.

Edhe nga diskutimet e pjesëmarrësve të tjerë u theksua nevoja për koordinim më të madh ndërinstitucional, financim të qëndrueshëm dhe reforma që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimit, përtej hartimit të strategjive dhe politikave arsimore.

NJË BURRË DHE NJË FOSHNJË GJENDEN TË VDEKUR NË GJILAN, ARRESTOHET NJË I DYSHUAR



GJILAN, 2 NËNTOR - Një burrë është arrestuar të dielën pasdite në Gjilan, i dyshuar për "vrasje të rëndë", disa orë pasi autoritetet gjetën pa shenja jete djalin dhe foshnjën e tij, njoftoi Policia e Kosovës.

Policia tha se u njoftua rreth orës 08:47 se në një shtëpi në fshatin Demiraj të komunës së Gjilanit dyshohej për dy trupa të pajetë, një burrë 27-vjeçar dhe foshnja e tij disamujore. "Me urgjencë në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet përkatëse policore, prokurori i Shtetit dhe ekipi emergjent mjekësor, ku nga mjeku kujdestar është konstatuar se të dy personat janë pa shenja jete", thuhet në njoftim.

Policia shtoi se hetimet fillestare tregojnë se dyshohet se incidenti ka ndodhur brenda familjes. Për këtë, policia e ka arrestuar babanë e viktimës, 65 vjeç, dhe e ka dërguar në mbajtje për 48 orë. "Në bashkëpunim me prokurorin e shtetit janë duke u ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme operative dhe hetimore për ndriçimin dhe sqarimin e plotë të rrethanave të rastit, i cili është cilësuar si 'vrasje e rëndë'", tha policia.

Trupat e viktimave janë dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë për obduksion, theksoi ajo.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka reaguar pas kësaj tragjedie.

Përmes një postimi në "Facebook", Hyseni ka shprehur ngushëllimet e tij dhe të komunës së Gjilanit për familjarët dhe të afërmit e viktimave, duke e cilësuar ngjarjen si një tragjedi që ka prekur të gjithë qytetarët. "Sot komuna jonë u trondit nga lajmi i rëndë për humbjen e dy jetëve në fshatin Demiraj. Në këto momente të vështira, ndajmë dhimbjen me familjarët. Humbja e jetëve në rrethana që ende nuk janë sqaruar në tërësi është një tragjedi që na prek secilin. Në emër të Komunës së Gjilanit, shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve dhe të afërmve të tyre", ka shkruar Hyseni.


Ai gjithashtu ka kërkuar që organet e rendit dhe të drejtësisë të angazhohen plotësisht për zbardhjen e rrethanave të rastit.

NË MIRDITË, ÇMIMI PËR VEPRËN JETËSORE "TEUTA" I AKORDOHET PAS VDEKJES DR. FLORA BROVINËS

Vendimi që Flora të ishte laureatja e 12-të e këtij çmimi u mor në fillim të vitit, ndërsa Çmimi iu dorëzua djalit të saj, Ylli Begajt. Me këtë rast u promovua edhe përmbledhja e saj poetike "Pas frymës FJALA…", si dhe antologjia e dytë Muzat e Alpeve/Çmimi TEUTA për të vazhduar aktiviteti me mbrëmjen poetike "TEUTA" për Florën, në Deçan.



Mirdita e kulturës, traditës, burrërisë, besës, rezistencës dhe e dinjitetit kombëtar, Shoqatën Rajonale të Shkrimtarëve "TEUTA" e priti në Rubikun e monumenteve të shumta kulturore e historike, në gjirin e të cilit shkrimtarë shqiptarë dhe malazezë nga Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria, realizuan edicionin e 12-të të Manifestimit Letrar Trekufitar, "Muzat e Alpeve". Në këtë djep të mendjeve krijuese, që i dhanë emër kësaj treve e kombit mbarë, si dhe në vendin e qëndresës kombëtare të burgut të Spaçit, mes emocioneve të veçanta të të pranishmëve si dhe në praninë e familjarëve të saj u nderua një ndër figurat më emblematike të kulturës, shoqërisë dhe rezistencës kombëtare shqiptare, dr. Flora Brovina. Sepse kultura asnjëherë nuk mund të jetë një ishull i shkëputur nga zhvillimet në shoqëri, tha në hapje të manifestimit shkrimtarja dhe gazetarja Ajetë Sh. Beqiraj, kryetare e kësaj shoqate.



Beqiraj: Kultura s'mund të jetë ishull i shkëputur nga zhvillimet në shoqëri

"Ndaj, nga kjo trevë me histori e qëndresë, Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve 'TEUTA' mbështet çdo zë që ngrihet për barazi, liri dhe një jetë të dinjitetshme, kundër diskriminimit, shtypjes dhe çdo force që cenon të ardhmen e kombit, integritetin e vendit, pronën dhe dinjitetin e qytetarit. Sepse qëndresa nuk është vetëm kujtim i së kaluarës, por përgjegjësi për të ardhmen tonë!", tha në hapje të manifestimit Beqiraj.

Shoqata "TEUTA" deri më tani ka përshkuar, me veprimtaritë e saj, 25 qytete të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ndërsa realizimin e edicionit të 12-të në Mirditë e mundësuan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, komuna e Deçanit dhe Bashkia e Mirditë.

Melyshi: Mbështetja e kulturës, detyrim që Mirdita e meriton

Kryetari i Bashkisë së Mirditës, Albert Melyshi, theksoi se bashkëpunimi dhe mbështetja institucionale për veprimtari të tilla kulturore janë detyrim, por edhe nder për institucionet vendore. "Ju falënderoj që keni zgjedhur Mirditën për t'u takuar, për të kujtuar, diskutuar dhe ndarë momente të veçanta mes krijuesve. Më vjen mirë që jeni këtu dhe ju siguroj se do ta keni gjithmonë mbështetjen e Bashkisë dhe të institucioneve tona. Aktivitete të tilla e pasurojnë jetën kulturore e artistike dhe i japin gjallëri jetës letrare, të cilën Mirdita e ka të domosdoshme dhe e meriton", u shpreh Melyshi.

Dedaj: Ndër traditat mirditore, 'poeteshat e vajit'


Shkrimtari, publicisti dhe studiuesi, profesor Ndue Dedaj, solli në vëmendje të të pranishmëve traditën e shkëlqyer rapsodike dhe atë të poetëve popullorë. "Sidomos, një traditë e veçantë që lidhet me poeteshat e vajit, apo vajtimoret, siç i quajmë ne. Ndërsa, Rubiku dhe Mirdita kanë nxjerrë një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë shqiptare, Abat Preng Doçin, i cili ka lindur në këtë vend dhe ka qenë edhe kryetar i Shoqërisë Letrare Gjuhësore 'Bashkimi' në Shkodër, ku ishin të pranishëm shkrimtarë si Gjergj Fishta apo Shtjefën Gjeçovi, të cilët kanë shërbyer edhe si misionarë në kuvendin françeskan të Rubikut".

Studiuesi Vlashi: Në Mirditë u vendosën themelet e shtetformimit

Përderisa historiani dhe studiuesi Julian Vlashi, drejtor i Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit në Bashkinë Mirditë, solli në vëmendje se gjendemi në rrënjët e fisit ilir të Pirustëve, i njohur në kohën antike për zejen e metalpunimit, për përpunimin e mineraleve, si dhe për karakterin e luftarak dhe qëndrestar, gjurmët e të cilëve i hasim në disa zona të Mirditës. "Edhe në periudhën mesjetare, në këtë territor u hodhën themelet e shtetformimit, në Principatën e Arbërit, e cila, siç kanë theksuar një sërë studiuesish dhe njohësish të historisë arbërore, në fund të shekullit XII dhe në fillim të shekullit XIII, e kishte qendrën në Ndërfanë, ku u ndërtua edhe bazilika e Shna Premtes, sipas testamentit të Priftit të Arbërit..."- shtoi Vlashi.

Rudolf Marku: Antologjitë e 'Teutës', libra me shije të përkorë

Video-rezymeja e veprimtarisë së "Teutës" solli sekuenca nga ndarja e Çmimit për Vepër Jetësore "TEUTA" 11-të laureatëve të saj, për të vijuar me promovimin e antologjisë së dytë të "TEUTËS", e cila përmbledh fragmente dhe poezi nga krijimtaria e pesë laureatëve më të fundit: Nazmi Rrahmani, Zuvdija Hoxhiq Berisha, Xhevahir Spahiu, Rexhep Qosja dhe Zija Çela. Shkrimtari i shquar Rudolf Marku në parathënien e librit shkruan se: 'Antologjitë që vinë çdo pesë vjet, me krijimtarinë e laureatëve të Çmimit për Vepër Jetësore "Teuta", janë libra me një shije të përkorë estetike, ku takohen emra dhe vepra ndër më të spikaturat e letërsisë shqipe dhe malazeze. Ato nuk janë vetëm një përmbledhje e veprave të nderuara me çmim; janë dëshmi e një udhëtimi të përbashkët kulturor, një kujtesë e shkruar e asaj që letërsia mund të bëjë atëherë kur kufijtë gjeografikë nuk bëhen kufij shpirtërorë. Se janë pikërisht këto faqe që mbesin dëshmi e këtij udhëtimi. Ato dëshmojnë se popujt mund të kenë histori, gjuhë dhe kujtime të ndryshme, por mund të ndajnë të njëjtën dritë të artit. Dhe kjo dritë, kur ruhet e përcillet nga brezi në brez, nuk njeh as kohë, as kufij"- shkruan Rudolf Marku në parathënien e librit.




Martinoviq: 'Teuta' dhe 'Muzat e Alpeve', një qëndismë e bukur pas kohëve të trazuara...



Përderisa, gazetar dhe shkrimtari Mirash Martnoviq, redaktor në gjuhën malazeze vlerëson se: "Në historinë e dy popujve tanë malazez dhe shqiptar, Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve "Teuta" dhe karvani i saj "Muzat e Alpeve" do të mbetet një gjurmë e qëndisur bukur pas kohëve të trazuara… Sepse, ky karvan ngarkuar me librat, poezinë dhe fjalën e bukur udhëtoi e zbarkoi nëpër 25 qytete të Kosovës, Malit të Zi dhe të Shqipërisë, duke lënë shembullin më të mirë të njohjes dhe të këmbimit kulturor ndërmjet popujve".

Redaktorja e librit Kaleziq: Me fjalën e shkruar po kapërcejmë barrierat gjuhësore

Ndërsa me përmbledhjen poetike të dr. Flora Brovinës "Pas frymës FJALA…" ("Poslije daha RIJEČ…") përkthyer nga Qazim Muja, "Teuta" serish kapërcen kufijtë gjuhësorë dhe u drejtohet lexuesve si një dëshmi se fjala e shkruar mund të mbijetojë përtej kohës, heshtjes dhe mungesës fizike të autorit."Leximi I poezisë së Florës më zbuloi një botë të re. Ajo është poezia e vuajtjes dhe e rezistencës. Njëra i kushtohet natyrës, trupit dhe dashurisë, kurse tjetra lirisë, qëndresës kombëtare dhe dinjitetit njerëzor. Gjatë leximit të këtij cikli poetik kam vërejtur sa shumë të përbashkëta kemi me Florën. Ndonëse njiheshim pak, përmes këtij libri të mrekullueshëm jemi afruar dhe jemi njohur në një dimension tjetër, atë të shpirtit dhe të poezisë. Mirënjohje talentit të Florës, dinjitetit të saj dhe forcës së heshtur të gruas. Asaj force, vulë së cilës përballoi e kapërceu kaq shumë sfida në jetë".



Xhevat Limani: Flora Brovina në panteonin botëror të poezisë së angazhuar

Video-kujtimi "Homazh për Florën" i parapriu ndarjes së Çmimit për Vepër Jetësore "TEUTA" pas vdekjes për dr. Flora Brovinën. Arsyetimin e solli shkrimtari, aktori dhe regjisori i mirënjohur Xhevat Limani, sipas të cilit Flora Brovina është ndër poetët e rrallë të letërsisë botërore e cila ka përdorur poezinë si zë të lirisë, qëndresës dhe dinjitetit njerëzor.„Poezia e Flora Brovinës ngërthen një vistër të gjerë motivesh shqetësuese për fatin e popullit shqiptar në Kosovë dhe më gjerë. Thirrjet e saja poetike për paqe dhe dashuri njerëzore janë kryeboshti tematikë e një strukturimi të ndjeshëm poetik. Ajo shkruan vargun me mjeshtri poetike, me emocione njerëzore, me një gjuhë të kulluar dhe me porosi të qarta që njerëzimi të notojë në oqeanin poetik të harmonisë njerëzore. Jeta dhe krijimtaria e shkrimtares Flora Brovina ecin paralel dhe shpesh shkrihen e huazohen me njëra-tjetrën. Poezia e angazhuar e Flora Brovinës, e radhit atë jo vetëm në Panteonin e femrave më të mira krijuese shqiptare, por edhe në Panteonin e rralluar të poezisë së angazhuar në letërsinë botërore" (Arsyetim i „TEUTËS" nga Xhevat Limani, prill 2026).

Ylli Begaj: Faleminderit që u mblodhët për ta nderuar veprën e nënës sonë!

Nën emocionet dhe peshën e një mungese të pazëvendësueshme, çmimin për Vepër Jetësore "Teuta" dedikuar dr. Flora Brovinës e pranoi



I biri, Ylli Begaj, i cili falënderoi të pranishmit për nderimin e veprës dhe të kujtimit të nënës së tij."Ju falënderoj të gjithëve që u mblodhët për të nderuar kujtimin dhe veprën e nënës sonë. Ajo e kishte shumë për zemër këtë manifestim, fliste shpesh për të dhe në të kaluarën merrte pjesë me shumë dëshirë. Sot, edhe pse nuk është fizikisht mes nesh, jemi thellësisht të lumtur që kujtimi, fjala dhe vepra e saj vazhdojnë të jetojnë. Ju falënderojmë nga zemra për këtë nderim", u shpreh Ylli Begaj.

Ramosaj: Koncepti i 'Teutës', në përputhje me synimet bashkëpunim e paqe

Karvani i vogël "Muzat e Alpeve" vazhdoi nderimin e figurës së dr. Flora Brovinës në Sallën e bibliotekës në Qendrën Rinore, me mbrëmjen poetike "TEUTA për Florën". Me këtë rast, kryetari Bashkim Ramosaj tha: "Uroj të keni kaluar mirë në Mirditë dhe I gëzohem faktit që kemi një manifestim të tillë. Uroj që edhe ky edicion të mbetet brenda konceptit tuaj, krejt ndryshe nga ajo që jemi mësuar të shohim. Fundja, synimi i të gjitha nismave tona është



integrimi, bashkëpunimi, shkëmbimi i përvojave dhe ndërtimi i paqes për brezat që vinë pas nesh"- tha në pritjen e shkrimtarëve kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj.

Mjeku, LShK: Flora mbetet figurë emblematike dhe e pakrahasueshme në të gjitha fushat

Ndërsa nënkryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Xheladin Mjeku, e kujtoi Florën si "një figurë emblematike, në fushën e letërsisë, si humaniste dhe një luftëtare e pathyeshme deri në frymën e fundit. "Dhimbja do të jetë e pranishme gjithmonë për

mungesën e saj. Por vepra e gjithë asaj që ajo la pas në të gjitha fushat është një shembull të cilit vështirë ia gjen krahasimin".

Ali Daci: "Tejet i lumtur që vendimi për Çmimin "TEUTA" ishte unanim"

Ali Daci, shkrimtar, aktivist dhe punëtor arsimi nga Rozhaja, me një rol të veçantë në artin, kulturën dhe arsimin e shqiptarëve në Mal të Zi, filloi evokimin e kujtimeve me Flora Brovinën që nga poezia, aktiviteti i saj humanitar para, gjatë luftës, eksodit e deri në burgimin e saj si dhe emocionin e çlirimit dhe vazhdimësinë e miqësisë dhe të bashkëpunimit. "Dhe, unë jam tejet i lumtur që vendimi i shoqatës në fillim të vitit për dhënien e çmimit TEUTA Florës unanim, Por, ja që jeta ka të papriturat e veta….".
Zëri i Klinës vjen nëpërmjet romancierit Vilson Culaj, i cili mendon se: "Vlerat letrare, humane e kombëtare duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë sa janë gjallë, jo vetëm kur kalojnë në amshim e përtej varrit. Këtë mision besoj se e kryem me ndërgjegje, me përzgjedhjen e Florës si laureate, pak para ikjes së saj fizike, si dhe me ndarjen e këtij çmimi sot, në Rubik të Mirditës. Sepse Flora gjakonte për Shqipërinë natyrale dhe këtë ideal e shprehte si në letërsi, ashtu edhe përmes veprimtarisë politike e kombëtare, të cilën e dëshmoi edhe me sakrificën e saj, Mirdita, kjo vatër e titanëve



dhe e rezistencës kombëtare, dhe Deçani i burrërisë e trimërisë, ditën ta vlerësojnë figurën shumëdimensionale të Flora Brovinës bashkë me ne. Sepse, artin nuk e përbëjnë numrat as shumica, por pakica



Boris Kastel: Lidhja jonë, më e fortë, mbretëresha jonë

Përderisa sipas poetit malazez Boris Jovanović Kastel, i njohur edhe si "Poeti i Mesdheut", lidhjet historike ndërmjet popujve, si në trashëgiminë shpirtërore po ashtu në prejardhje e në territor, janë të panumërta. Por, lidhja më e fortë që na bashkon në këtë manifestim shkrimtarësh shqiptarë dhe malazezë është mbretëresha jonë e madhe, Teuta, e cila, sipas burimeve historike, sa ishte e bukur, po aq ishte edhe e guximshme. Emri i saj na mbledh edhe rreth poezisë, sepse, në mitologjinë greke, poetët janë hyjnorë: ata shpërndajnë paqe, ndërtojnë




si ne që e duam, e vlerësojmë apo e krijojë dhe e përçojë tek pjesa tjetër. Dhe "Muzat e Alpeve" ngrenë lart vlerat njerëzore, letrare dhe universale të krijuesve eminentë, me theks të veçantë sivjet, ato të Flora Brovinës!".
Për poeten shkodrane Farida Zmijani-Ramadani, Flora në poezi ishte e brishtë ndërsa e fuqishme në jetë. Ajo fliste për forcën e gruas dhe përqendrimin e kësaj force për të triumfuar. "Kur shihnim natyrën e saj të qete pyesnim vetvetiu: "Si ka mundësi që një grua kaq e qetë të jetë kaq e guximshme në jetë? Gra të tilla meritojnë respektin e të gjithëve!"



ura dhe ndërlidhin kultura. Ndaj fjalën do ta përmbyll me thënien e Borgesit se "biblioteka është parajsa e fundit mbi tokë".

Më 2014 "Teuta" realizoi edhe turin "Shkrimtarët lobojnë për Kosovën" në Rumani

E themeluar në shkurt të vitit 2013, Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve "TEUTA" ka nderuar me Çmimin për Vepër Jetësore dymbëdhjetë korifej të letërsisë shqipe dhe malazeze: Jevrem Bërkoviq, Dritëro Agolli, Ramiz Kelmendi, Mirash Martinoviq, Moikom Zeqo, Nazmi Rrahmani, Zuvdija Hoxhiq Berisha, Xhevahir Spahiu, Rexhep Qosja, Zija Çela, Sreten Peroviq dhe Flora Brovina, së cilës çmimi iu nda pas vdekjes. Flora Brovina u nda nga jeta më 15 shtator 2026, në moshën 77-vjeçare, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar letrare, njerëzore dhe kombëtare. Ndërsa botimet e saj në gjuhë shqipe dhe malazeze janë: "Prej të cilave janë edhe dy botimet më të fundit antologjia "Muzat e Alpeve"/ Çmimi TEUTA II si dhe "Pas frymës FJALA…", me poezi të zgjedhura të dr. Flora Brovinës, e cila ndërroi jetë vetëm një muaj para pranimit të çmimit të akorduar disa muaj më parë, në nderim të kontributit të çmuar njerëzor,kombëtar dhe letrar.




SHTATË VJET PA ROLAND KAÇANIN - LANDIN, NJERIUN QË LA GJURMË DHE NUK HARROHET KURRË

Në përvjetorin e shtatë të ndarjes nga jeta të ish-drejtorit të KS Sigma në Prishtinë, kujtojmë me mall, respekt dhe mirënjohje njeriun që la gjurmë të veçanta në jetën e kompanisë dhe të kolegëve të tij.

Ka njerëz që koha i largon nga përditshmëria jonë, por kurrë nga kujtesa dhe zemrat tona. I tillë ishte Roland Kaçani - Landi (8 mars 1973 - 3 nëntor 2019), miku ynë i çmuar, kolegu i respektuar dhe drejtuesi i suksesshëm i KS Sigma në Prishtinë. Në shtatëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta, e kujtojmë me mall të pashuar, dhimbje të thellë dhe mirënjohje të përhershme për njeriun, personalitetin dhe kontributin e çmuar që la pas.

Rolandi nuk ishte vetëm një drejtues i suksesshëm. Ai ishte një personalitet që dinte ta ndërtonte suksesin mbi profesionalizmin, përkushtimin, ndershmërinë dhe respektin njerëzor. Për të, puna nuk ishte vetëm detyrë, por përgjegjësi, ndërsa suksesi nuk ishte meritë individuale, por rezultat i bashkëpunimit, besimit dhe angazhimit të përbashkët.





Ajo që e bënte Landin të veçantë ishte mënyra se si i trajtonte njerëzit. Ishte i afërt me punëtorët, i drejtë në vlerësime, i matur në vendime dhe gjithmonë i gatshëm ta çmonte mundin e secilit. Ai dinte të dëgjonte, të mirëkuptonte, të motivonte dhe të bashkonte njerëzit rreth qëllimeve të përbashkëta. Me urtësinë, qetësinë dhe sjelljen e tij njerëzore, kishte fituar respektin jo vetëm të kolegëve, por të të gjithë atyre që patën rastin ta njihnin dhe të bashkëpunonin me të.

Kontributi i tij në KS Sigma nuk matet vetëm me rezultatet e arritura gjatë drejtimit të tij, por edhe me frymën e punës, kulturën e bashkëpunimit dhe vlerat njerëzore që la pas. Këto janë gjurmë që nuk fshihen me kalimin e viteve, sepse janë ndërtuar mbi karakterin, përkushtimin dhe respektin për njeriun.



Sot, shtatë vjet më vonë, mungesa e tij ndihet ende. Na mungon prania e tij, fjala e matur, buzëqeshja, këshilla dhe mënyra e veçantë se si dinte t'i bënte njerëzit të ndiheshin të vlerësuar. Por, krahas dhimbjes për mungesën e tij, mbetet krenaria që patëm fatin ta kishim mik, koleg dhe bashkëpunëtor.

Vitet kalojnë, por vlerat e vërteta nuk plaken. Njerëzit e mëdhenj nuk mbahen mend vetëm për pozitat që kanë ushtruar apo sukseset që kanë arritur, por mbi të gjitha për mënyrën se si kanë jetuar, si i kanë trajtuar të tjerët dhe çfarë kanë lënë pas. Roland Kaçani ishte njëri prej tyre.

Në këtë përvjetor, në emër të kolegëve dhe gjithë kolektivit të Kompanisë Sigma në Kosovë, shprehim respektin dhe mirënjohjen tonë të thellë për jetën, punën dhe kontributin e tij. Familjes Kaçani i përcjellim ngushëllimet tona më të sinqerta, duke ndarë me të dhimbjen për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

I dashur Landi, shtatë vjet kaluan, por kujtimi për ty nuk u zbeh. Koha nuk e fshin respektin, as mungesa nuk i shuan gjurmët e një njeriu që ka lënë vlera pas vetes. Do të mbetesh përherë pjesë e historisë së Sigma-s dhe e kujtimeve tona më të çmuara.

Pusho në paqe, Landi! Kujtimi për ty do të jetë i përhershëm!

Me respekt dhe mirënjohje të përhershme,

Bali Mahmuti dhe i gjithë kolektivi i Kompanisë Sigma në Kosovë







sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

MALISHEVA RUAN KREUN E TABELËS, PRISHTINA E NDJEK NGA AFËR

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Malisheva vazhdon ta kryesojë Albi Mall Superligën e Kosovës pas xhiros së 12, ndonëse është ndalur në barazim pa gola nga Feronikeli 74 në shtëpi. Skuadra ka 27 pikë, vetëm një më shumë se Prishtina, e cila ka fituar 1:0 në udhëtim ndaj Llapit dhe ka një ndeshje më pak të zhvilluar.
Malisheva nuk ka arritur ta shfrytëzojë përparësinë e terrenit vendas, ndërsa Xhemail Ibishi ka humbur një penallti në minutën e 35-të. Ky ishte barazimi i tretë i saj në kampionat. Feronikeli 74 renditet në vendin e shtatë me 12 pikë.
Prishtina e ka siguruar fitoren ndaj Llapit me golin e kapitenit Leotrim Kryeziu, të realizuar në minutën e katërt. Kryeqytetasit kanë 26 pikë nga 11 ndeshje, ndërsa Llapi mbetet në vendin e parafundit me vetëm pesë pikë.
Në këtë xhiro Drita ka shënuar fitoren e katërt radhazi, duke e mposhtur Vushtrrinë me



rezultat 3:1. Për kampionen në fuqi kanë realizuar Mike Arthur, Kemelho Nguena dhe Albert Dabiqaj, ndërsa Albion Shurdhiqi ka shënuar për mysafirët. Drita ka 23 pikë, kurse Vushtrria mbetet e fundit me tri pikë.
Ballkani ka triumfuar bindshëm ndaj Drenicës me rezultat 4:0. Albin Berisha ka realizuar dy gola, ndërsa Giovanni Ribeiro dhe Diar Vokrri nga një. Ballkani ka arritur në 19 pikë, aq sa ka edhe Gjilani, i cili ka barazuar 1:1 në udhëtim ndaj Dukagjinit. Gjilani e ka shmangur humbjen në minutën e 93-të, kur Armend Thaqi ka shënuar nga penalltia. Dukagjini ka 18 pikë, ndërsa Drenica 11.

RENDITJA TABELARE:

Malisheva	27 pikë
Prishtina	26 pikë
Drita	23 pikë
Ballkani	19 pikë
Gjilani	19 pikë
Dukagjini	18 pikë
Feronikeli 74	12 pikë
Drenica	11 pikë
Llapi	5 pikë
Vushtrria	3 pikë

XHAKA I ZHGËNJYER PAS HUMBJES SË SUNDERLANDIT: NUK E DI ÇFARË DUHET TË NDRYSHOJMË

Granit Xhaka nuk e ka fshehur zhgënjimin pas një tjetër humbjeje të Sunderlandit në Ligën Premiere. Këtë herë skuadra e tij është mposhtur me rezultat 3:1 në udhëtim nga Coventry City, ndërsa kapiteni shqiptar ka pranuar se nuk e di se çfarë duhet të ndryshojë për ta nxjerrë ekipin nga kriza.
Xhaka ka qenë tejet i zhgënjyer pas ndeshjes, e cila e ka lënë Sunderlandin në fund të tabelës së Ligës Premiere, me vetëm pesë pikë të grumbulluara pas nëntë xhirove.
Mesfushori ka theksuar se skuadra kishte udhëtuar me optimizëm dhe ishte përgatitur mirë gjatë javës, por nuk arriti ta zbatonte në fushë atë që



ishte diskutuar në dhomat e zhveshjes. "Është e vështirë, një ndjenjë krejtësisht ndryshe. Është e vështirë për t'u pranuar. Erdhëm këtu me shumë shpresë dhe u përgatitëm shumë mirë gjatë javës, por nëse nuk i bëni gjërat për të cilat përgatitemi dhe për të cilat flasim në dhomat e zhveshjes, nuk ka asnjë mundësi për të fituar ndonjë ndeshje", ka deklaruar Xhaka.
Sunderlandi kishte regjistruar një fitore ndaj Brentfordit në Carabao Cup gjatë javës, por nuk arriti ta bartte atë formë edhe në kampionat. "Po, por kjo nuk mjafton. Jo në këtë ligë. Nuk është e mundur që një ditë të jesh mirë dhe ditën tjetër keq. Është e vështirë të vazhdohet kështu, sepse duhet të ndryshojmë diçka. Nuk e di çfarë të ndryshoj", është shprehur ai.
Xhaka ka kritikuar gabimet e shumta të skuadrës, duke theksuar se lojtarët po dështojnë edhe në veprimet më elementare. "Ka shumë gabime nga ana jonë, pasime të thjeshta, duele të thjeshta që nuk po i fitojmë. Nëse nuk i ke fillimisht gjërat elementare, harroji të tjerat. Ndjenja është e tmerrshme në këtë çast", ka shtuar mesfushori.
Në vazhdim skuadrën e drejtuar nga Regis Le Bris e presin dy ndeshje të rëndësishme në shtëpi: fillimisht ndaj Dinamo Zagrebit në Ligën e Evropës dhe më pas kundër Chelseat në kampionat. Xhaka e ka pranuar se i kupton frustrimet e tifozëve, por u ka bërë thirrje të gjithëve të qëndrojnë të bashkuar në këtë periudhë të vështirë. Ai ka shprehur bindjen se Sunderlandi ka potencialin për t'u rikthyer. "Është e vështirë edhe për tifozët. E di që janë të frustruar, por është e njëjta gjë edhe për ne. Duhet të qëndrojmë të bashkuar deri në fund. Kjo nuk është diçka e panjohur për këtë klub. Ka një kuptim të madh për ne dhe për ta që të qëndrojmë së bashku dhe të besojmë te njëri-tjetri. Kur gjithçka shkon mirë, është e lehtë ta mbështesësh dikë. Kur gjërat shkojnë keq, atëherë shihet se kush qëndron pranë teje dhe kush jo. Na duhen të gjithë: vetja jonë, bashkëlojtarët, stafi dhe tifozët. Jam i bindur dhe besoj shumë se mund të rikthehemi, por duhet t'i ndalim gabimet që po i bëjmë", ka përfunduar Xhaka.

MEDIET ITALIANE KËRKOJNË MË SHUMË MINUTA PËR EDON ZHEGROVËN TE JUVENTUSI



TORINO, 2 NËNTOR - Trajneri i Juventusit, Luciano Spalletti, duhet t'i japë më shumë minuta sulmuesit Edon Zhegrova. Këtë vlerësim e kanë bërë disa prej medieve të njohura italiane dhe evropiane pas paraqitjes së tij në fitoren 2:0 ndaj Napolit. Ylli i Kosovës ishte sërish protagonist te "Zonja e Vjetër", duke asistuar në njërin prej golave të skuadrës. Me inkuadrimin e tij në fushë, Zhegrova i dha më shumë gjallëri sulmit të Juventusit, duke tentuar vazhdimisht driblime dhe harkime, si dhe duke provuar dy herë të shënonte nga distanca.
Një statistikë interesante është se Zhegrova, brenda vetëm tri minutave, regjistroi më shumë goditje sesa dy qendërsulmuesit Kolo Muani dhe Nick Woltemade gjatë gjithë ndeshjes. Pas paraqitjes së tij, disa medie të njohura, si "Goal", "Tuttomercatoweb" dhe "Corriere della Sera", kanë vlerësuar se sulmuesi nga Kosova meriton më shumë hapësirë në skuadrën e Spallettit. "Nga një aksion i tij lindi goli për 1:0. U fut në lojë dhe i dha gjallëri skuadrës. Padyshim, meriton më shumë hapësirë", ka shkruar "Tuttomercatoweb". "Freskia dhe energjia e re që bëjnë diferencën", ka vlerësuar "Corriere della Sera".
Ndërsa "Goal" ka veçuar ndikimin e Zhegrovës në sulmin e Juventusit dhe presionin që ai i shkaktoi skuadrës mysafire. "I futur në lojë në minutën e 59, Zhegrova solli freski dhe më shumë depërtim në sulmin e Juventusit. Rreth minutës së 75-të ai pati dy goditje radhazi që u bllokuan nga mbrojtja e Napolit, duke e mbajtur kundërshtarin nën presion, ndërsa Juventusi kërkonte golin e fitores", ka shkruar "Goal".

Valencia e fut Vedat Muriqin në listën e dëshirave për afatin kalimtar të janarit

STAMBOLL, 2 NËNTOR - Një lajm i papritur për të ardhmen e Vedat Muriqit është publikuar në mediet turke, ku raportohet se sulmuesi nga Kosova mund të largohet nga Fenerbahçe gjatë afatit kalimtar të janarit. Sipas mediumit turk "NTV Spor", Valencia e ka përfshirë 32-vjeçarin në listën e kandidatëve për përforcimin e repartit ofensiv dhe po shqyrton mundësinë e transferimit të tij.
Klubi spanjoll synon të afrojë një qendërsulmues gjatë afatit kalimtar dimëror, ndërsa preferenca e tij është që transferimi të realizohet në formë huazimi. Përveç Muriqit, në listën e Valencias ndodhen edhe dy emra të njohur të futbollit evropian, Artem Dovbyk dhe Richarlison. Megjithatë, transferimi i sulmuesit nga Kosova nuk pritet të jetë i lehtë, pasi ai ka kontratë me Fenerbahçen deri më 30 qershor 2029. Për këtë arsye, Valencia duhet të gjejë një formulë të përshtatshme financiare për ta bindur klubin turk që ta lejojë largimin e tij. Muriqi ka pasur një sezon pozitiv deri më tani, duke realizuar tetë gola dhe duke dhuruar dy asistime në 16 paraqitje zyrtare me fanellën e Fenerbahçes. Mbetet të shihet nëse interesimi i Valencias do të konkretizohet me një ofertë zyrtare gjatë afatit kalimtar të janarit.







NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "TRIVIUM" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811428417 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "TRIVIUM" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811428417 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "TRIVIUM" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811428417 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë: 03.11.2026

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) nenet 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri*"* Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nenet 21 dhe 33, nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Rregullores Nr.01/31/24 date 31.01.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë nenet 4,11, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 20.10.2026 shpall:

K O N K U R S

1. Konkurse për zgjedhje/rizgjedhje për vendet e punës:
   (1) Këshilltar shkencor për shekullin XX.

Kandidati/ja për Këshilltar shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit te shkencave.
- Të tregoje nivel të lartë kompetence e përvojë shkencorë për fushën (periudhën historike) qe dëshmohet.
- Të ketë dy (2) vepra shkencore monografike, një pas zgjedhjes së fundit dhe dy (2) vëllime me dokumente, një pas zgjedhjes së fundit, nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të larte dhe akademitë e shkencave.
- Më së paku pese (5) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
- Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- Përvojë së paku në dy (2) projekte kërkimore-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale.
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse.
- Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi.
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj.
- CV-të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, "Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve" dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"*.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në administratën e Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* në Prishtinë, në adresën Eqrem Qabej nr. 111.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datum: 03.11.2026. godine

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02. maj 2013. godine), članova 24 i 35, Statuta Instituta za istoriju „Ali Hadri" Priština (01B-195, od 31.10.2024. godine), članova 21 i 33, člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Pravilnika br. 01/31/24 od 31.01.2025. godine o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, članova 4 i 11, Naučno veće Instituta za istoriju „Ali Hadri" Priština, na sednici održanoj dana 20.10. 2026. godine, objavljuje:

K O N K U R S

1. Konkurs za izbor/reizbor za radna mesta:
   (1) Naučni savetnik za XX vek.

Kandidati/kinje za naučnog savetnika moraju ispunjavati sledeće uslove:

- Da imaju zvanje doktora nauka.
- Da pokažu visok nivo kompetentnosti i naučnog iskustva za oblast (istorijski period) koja se dokazuje.
- Da imaju dve (2) naučne monografske publikacije, jednu nakon poslednjeg izbora, i dva (2) toma sa dokumentima, jedan nakon poslednjeg izbora, iz odgovarajućeg perioda, objavljena od strane naučno-istraživačkih institucija, visokoškolskih ustanova i akademija nauka;
- Najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima iz odgovarajućeg perioda, od kojih dva (2) nakon poslednjeg izbora, i da je uspešno učestvovao/la u organizovanju naučno-istraživačke delatnosti;
- Da ima aktivno učešće na najmanje tri (3) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna;
- Iskustvo u najmanje dva (2) naučno-istraživačka projekta, realizovana od strane naučno-istraživačkih i stručnih institucija;
- Sposobnost za rukovođenje naučno-istraživačkim i akademskim projektima.

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja treba da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu o završenim odgovarajućim studijama.
- Diplome stečene u inostranstvu moraju biti nostrifikovane u skladu sa važećim aktima.
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci.
- CV uz koji treba priložiti potrebne dokaze za potvrđivanje stanja navedenog u njemu.
- Dokaze o naučnim dostignućima (članci, knjige, itd.).

Izbor naučnog i istraživačkog osoblja Instituta za istoriju „*Ali Hadri*" vrši se u skladu sa odredbama na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02. maj 2013. godine), Statuta Instituta za istoriju „*Ali Hadri*" - Priština (01B-195, od dana 31. oktobra 2024. god.), člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, „Pravilnika o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača" i drugih relevantnih akata Instituta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednim dnevnim novinama, kao i na internet stranici Instituta za istoriju „*Ali Hadri*".

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Popunjene prijave se dostavljaju i protokolišu u administraciji Instituta za istoriju „*Ali Hadri*" u Prištini, na adresi Eqrem Qabej br. 111.


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË
ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
0.5L